



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 2.11.2020

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik Darjel Sina, në seancën gjyqësore të datës 2.11.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Pasi u njohëm me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat bashkëlidhur tyre, përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, me shkresën me nr.\*\*\* prot., datë 7.10.2020, nga ana e Kolegjit, duke i analizuar ato në raport me secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se mbeten për t’u marrë në shqyrtim e për t’u gjykuar, nga ana e këtij trupi gjykues, të gjitha shkaqet e ankimit, të pasqyruara edhe në parashtrimet e seancës gjyqësore parardhëse.

Referuar shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik për vendimin nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, dhe vendimit të ndërmjetëm të Kolegjit të datës 6.10.2020, për lejimin e marrjes në cilësinë e provave të një pjese të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit: (i) shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2019, e Shkollës së Magjistraturës, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2020, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe (iii) parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, në seancën e datës 6.10.2020, Komisioneri Publik vlerëson se, nga ana formale, aktet e paraqitura nga subjekti përbushin kërkesat formale për t’u administruar në cilësinë e provës.

Lidhur me parashtrimet, përmbajtjen e akteve dhe nivelit të provueshmërisë në lidhje me shkaqet e ankimit, vlerësojmë se:

**1. Për pasurinë nr.1, “Apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Durrës**

1.1. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, mbi pagesën e kështit të parë për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Durrës, ku vlerësohet se: subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti,

pasi depozita në shumën 1.048.600 (një milion e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë, që ai deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për këtë pagesë, nga aktet në dosje rezulton se nuk është tërhequr e gjitha përpara datës 30.4.2009,<sup>1</sup> kur është kryer pagesa e këstit të parë. (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të këtij apartamenti me një diferencë negative prej - 838.738 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë.

1.2. Komisioneri Publik, pasi analizoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit të datës 6.10.2020, vëren se subjekti nuk ka argumentuar apo ka paraqitur prova të reja, të cilat të provojnë të kundërtën e konstatimit të Komisionerit Publik, mbi pamundësinë financiare të subjektit për të kryer pagesën e këstit të parë të apartamentit, në shumën -838.738 lekë. Raporti Ekonomik<sup>2</sup> i referuar nga subjekti në këto parashtrime është administruar edhe më parë gjatë hetimit administrativ në Komision. Periudha e analizuar në raportin ekonomik të paraqitur nga subjekti është 1.1.2008 - 30.4.2009, nuk korrespondon me periudhën e deklaruar/analizuar, sipas deklaratave periodike vjetore. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar kursimet *cash* deri në datën 31.12.2008, analizimi i likuiditeteve në total, për periudhën 1.1.2008 - 30.4.2009, çon në një rezultat financiar jo të saktë, për fondet në dispozicion<sup>3</sup>. Komisioneri Publik kërkonte shpjegime për këtë shkak ankimi nga subjekti i rivlerësimit dhe paraqitjen e ndonjë prove në funksion të mbrojtjes së subjektit.

1.3. Përsa më sipër, Komisioneri Publik, pasi analizoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në datën 6.10.2020, vlerëson se: (i) nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e këstit të parë të këtij apartamenti, si dhe (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provoi apo paraqiti dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë të apartamentit për një diferencë negative prej - 838.738 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë.

1.4. **Lidhur me pagesën e këstit të dytë në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro.** Sa i përket burimit që ka shërbyer për shlyerjen e këtij kësti, në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, ndërsa në DV-2014, lidhur me burim e këtij kësti, subjekti ka deklaruar: “10.000 (dhjetë mijë) euro nga mbyllje e depozitës me nr. \*\*\* (shlyer borxhi me akt noterial \*\*\*, ky borxh është marrë për efekt të bankës, pasi afati për tërheqjen e depozitës ishte më datë \*\*\*.12.2014 dhe shlyerja është bërë në datën \*\*\*.5.2014)...”.

1.5. Komisioneri Publik, pasi analizoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në datën 6.10.2020, lidhur me pasaktësinë në deklaratën “Vetting” për burimin e pagesës së këstit të dytë për blerjen e pasurisë “Apartament”, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” ka pasur detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi dhe të shpjegonte dhe të provonte mjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të saj.

---

<sup>1</sup> Shuma 547.400 lekë është kaluar në datën 24.4.2009, nga llogaria e depozitës në llogarinë e pagës së subjektit, në \*\*\* Bank. Nga kjo shumë e transferuar në llogarinë e pagës deri në datën 30.4.2009, datë kur është bërë pagesa e këstit të apartamentit, janë tërhequr 120.000 lekë.

<sup>2</sup> Raporti Ekonomik, datë \*\*\*.5.20019, gjithsej 29 (njëzet e nëntë fletë), përpiluar nga Kontabël i Miratuar, znj. \*\*\*.\*\*\*, dorëzuar në Komision, pas kalimit të barrës së provës.

<sup>3</sup> Pasi nuk merr në konsideratë çfarë subjekti deklaroi gjendje në fund të vitit 2008, por përfshin të gjithë të ardhurat dhe presupozon se deri në datën 30.4.2009, subjekti i kanë mbetur më shumë kursime, pas zbritjes së shpenzimeve.

## **2. Për pasurinë nr. 2, llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, pranë Bankës \*\*\*, si dhe llogaritë dyemërore, të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

2.1. Në deklaratën “*Vetting*”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar, ndër të tjera, edhe depozitën bankare si vijon: “Depozitë me afat pranë Bankës \*\*\*, në emër të bashkëshortes së subjektit, në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) euro, me nr. llogarie: “\*\*\*\*”. *Burimi i krijimit*: Kursime nga paga e bashkëshortes ndër vite, bashkim me depozitën në vlerë 4.000 (katër mijë) euro, nr. “\*\*\*\*”, datë \*\*\*.12.2015, në Bankën \*\*\*, shitje automjeti i deklaruar me numër kontrate nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2015, në vlerën 2,000 (dy mijë) euro. *Pjesa takuese*:100%”.

2.2. Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit lidhur me këtë llogari, konstaton se: (i) Bashkëshortja e subjektit i ka përfituar interesat nga depozitat dyemërore;<sup>4</sup> (ii) rezultojnë kalime fondesh nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit në llogarinë dyemërore, në emër të \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* dhe anasjelltas; (iii) bashkëshortja e subjektit në këto llogari bankare dyemërore është në cilësinë e depozituesit/titullare e llogarive bankare dhe jo “person i besuar/autorizuar”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë në detaje këtë situatë juridike dhe të justifikojë bindshëm veprimet e kryera në këto llogari bankare.

### **3. Lidhur me llogaritë bankare të përbashkëta të padeklaruara**

3.1. Lidhur me llogaritë bankare dyemërore që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*\*.\*\*\*, ka pasur në \*\*\* Bank, me znj. \*\*\*.\*\*\* (nëna e subjektit të rivlerësimit) dhe me znj. \*\*\*.\*\*\* (nëna e saj), Komisioneri Publik, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore për vitet 2010 – 2016, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, ka konstatuar se depozitat e mësipërme nuk janë deklaruar.

3.2. Gjithashtu, Komisioneri Publik ka konstatuar: (i) Derdhje *cash* në llogaritë dyemërore të kryera nga vetë bashkëshortja e subjektit. (ii) Transferime fondesh nga llogaria dyemërore: \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* në llogarinë dyemërore: \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*. (iii) Janë përfituar interesa nga depozitat dyemërore.

3.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 6.10.2020, ka pretenduar se: “... *ndryshe nga sa pretendohet në shkaqet e ankimit të Komisionerit, nuk është e vërtetë që këto nuk janë deklaruar nga ana jonë, sikundër nuk është e vërtetë se këto llogari janë përdorur në cilësinë e titullarit. Këto janë të ardhura të prindërve të mi... Këto depozita nuk kanë qenë asnjëherë në pronësinë e subjektit apo të bashkëshortes, në kuptim të ligjit, ndaj dhe nuk mund të pretendohet se duhet të ishin deklaruar si pasuri e subjektit...*”.

3.4. Komisioneri Publik konstaton se, referuar akteve në dispozicion të hetimit të kryer nga Komisioni dhe të dhënave të institucioneve financiare, siç janë kontratat e depozitave bankare dhe nxjerrjet e llogarive bankare të depozitave nga Banka \*\*\*<sup>5</sup>, pretendimi i subjektit nuk qëndron.

3.5. Nga aktet e cituara konstatojmë se znj. \*\*\*.\*\*\* figuron bashkëtitullare në depozitat pranë Bankës \*\*\* dhe “*de jure*” edhe bashkëpronare e tyre, për këtë ka pasur detyrimin e deklarimit të

<sup>4</sup> Referohuni transaksionit të kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të datës \*\*\* – \*\*\*.5.2013, në llogarinë \*\*\*, në \*\*\* Bank.

<sup>5</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2018.

depozitave në DV-në respektive, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, “Mbi deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”.

3.6. Gjithashtu, në referencë të nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, i cili parashikon se: *“Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta”*, pjesa takuese e znj. \*\*.\*\*\* në këto depozita është 50% e tyre dhe, për këtë arsye, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, duhet analizuar lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

3.7. Referuar pretendimeve të subjektit, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën, nuk arriti të justifikojë veprimet dhe përfitimet nga këto llogari, si dhe të argumentojë bindshëm mosdeklarimet e llogarive dyemërore të analizuara më sipër.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**